



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2020:052609  
Datë: 10.05.2024  
Numri i dokumentit: 05670883

**E.nr.724/23**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit M.Q. nga Ferizaj, të cilën e përfaqëson av Fatos Pira nga Vitia, kundër debitorit Komuna e Ferizajt – Drejtoria e Arsimit, për pagesën e udhëtimit, ushqimit, dhe shpenzimet e procedurës, më datë 10.05.2024, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**PËRFUNDON** procedura përmbarimore në lëndën **E.nr.724/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

#### **A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.724/23, të datës 16.05.2023, e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit Komuna e Ferizajt – Drejtoria e Arsimit, për pagesën e të ardhurave të papaguara dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të aktgjykimit 2020:052609, të datës 16.02.2022.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 22.09.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 2,533.60 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbarimore në këtë çështje juridike përmbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**E.nr.724/23, më datë 10.05.2024**

**GJYQTARI**  
**Faton Ajvazi**